



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016 – 2020

Bashkia Elbasan

Viti 2018

Tabela e Përmbajtjes

Gjetjet Kryesore	3
Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Elbasan	5
Rezultatet e Monitorimit – Viti 2018	8
Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.	8
Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.....	16
Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin etyre, përmes programeve të specializuara.	24
Rekomandime	24

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2018.

Gjetjet Kryesore

- Këshilli Bashkiak i bashkisë Elbasan në vitin 2018 ka miratuar “*Planin e Veprimit për Barazi Gjinore 2018-2020.*”
- Gjatë vitit 2018, Bashkia Elbasan ka ngritur dy organizma në kuadër të barazisë gjinore, Aleancën e Grave Këshilltare në Këshillin Bashkiak dhe Komisionin e Barazisë Gjinore.
- Bashkia e Elbasanit është e para bashki në Shqipëri që ka aplikuar fillimisht parimet e Buxhetimit me Pjesëmarrje e më pas të Buxhetimit Gjinor.
- Përgjatë vitit 2018, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë, Bashkia Elbasan, janë evidentuar 192 raste të dhunës në familje dhe 120 kërkesa për urdhër mbrojtje. Nga rastet e evidentuara, 145 prej viktimave ishin gra dhe vajza.
- Mekanizmi i Referimit kundër dhunës në Familje në bashkinë Elbasan ka trajtuar 103 raste të dhunës në familje.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar 224 urdhëra të rinj, nga të cilët 150 UM dhe 69 UMM.
- Gjatë vitit 2018, bashkia Elbasan ka organizuar dhe koordinuar 42 aktivitete ndërgjegjësuese, në bashkëpunim me aktorët lokale publikë dhe ata jo publikë dhe nuk ka shpenzuar buxhet për këto aktivitete, duke qenë se ka vënë në dispozicion burimet e veta njerëzore dhe në natyrë.
- Rreth 5500 persona janë përfshirë në aktivitete përgjatë 2018-ës. Këto aktivitete më së shumti u fokusuan tek gratë/vajzat, burra/djem, të rinj/të reja, nxënës shkolle dhe studentë, target grupe gjithëpërfshirëse.
- Çdo vit organizohen rreth 150 aktivitete ndërgjegjësuese që realizohen dhe koordinohen nga OSHC-të në territorin e bashkisë Elbasan.
- Bashkia Elbasan ka të nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me disa OJF, si me “*Forumi i Gruas Elbasan*”, “*Tjetër Vizion*”, “*World Vizion*”, “*A2B*”, “*Romano Sezzi*” Forumin e OSHC-ve. Ka gjithashtu marrëveshje edhe me organizata të tjera lokale, kombëtare që realizojnë projekte në territorin e bashkisë Elbasan.
- Në bashkëpunim me OSCE, bashkia Elbasan në vitin 2018 organizoi një trajnim të përbashkët të anëtarëve të Komitetit Drejtues dhe Tryezës Teknike, lidhur me mekanizmin referues për bashkërendimin e punës në lidhje me viktimat e dhunës në familje.
- Mbështetja ndërsektoriale për rastet e dhunës në familje është ofruar nga funksionimi i Grupit Teknik Ndërdisiplinar për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Ky ekip për vitin 2018 realizoi 7 takime në të cilat u trajtuan rastet e identifikuara apo ato të referuara. Ndërkohë që Komiteti Drejtues pranë kësaj bashkie për vitin 2018 është mbledhur 3 herë.

- 8 gra të dhunuara kanë marrë bonuse, gra të cilat i përkasin komunitetit Rom dhe Egjiptian të cilat janë trajtuar gjatë vitit 2018 me bonus social.
- Mekanizmi i Referimit has në sfida dhe vështirësi në rastet e dhunës në familje si në: Mbledhjen e statistikave në nivel vendor për rastet e referuara dhe të menaxhuara në bashkinë Elbasan; Nevoja për qendër rehabilitimi për rastet e dhunës në familje me qëndrim afatgjatë; Fondi specifik për mbështetjen me shërbime emergjente të rasteve të dhunës në familje.
- Gjithashtu kërkohet edhe rritja e kapaciteteve të Ekipit teknik ndërdisiplinor në: Identifikimin e hershëm; Te kuptuarit e njëjtë të rrishtit dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje; Punësimin dhe Strehimin afatgjatë.
- Shërbimi i Provës ka trajtuar 17 Urdhëra ekzekutimi për UM, për ata burra që gjykata ka vendosur paraqitje në zyrën e shërbimit të provës.
- Bashkia Elbasan që nga viti 2010 ka të emëruar një Nëpunëse të Barazisë Gjimore që luan edhe rolin e Koordinatorës Vendore kundër dhunës në familje, e cila është znj. Marsida Sejdi. Ndërkohë që në Planin e Mbrojtjes Sociale 2016-2020 dhe në *“Planin e Veprimit për Barazinë Gjimore 2018-2020”* të kësaj Bashkie, ku është sugjeruar zgjerimi i *“Sektorit të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjimore”*, si dhe propozimi për ndarjen e funksioneve të Nëpunës/es së Barazisë Gjimore dhe Koordinator/es Vendor/e kundër dhunës në familje, përmes emërimit të dy personave me kohë të plotë.
- Sistemi REVALB ka nevojë për ndryshim moduli sipas specifikave të veçanta që ka çdo rast. Gjithashtu, koordinatorja e kësaj bashkie sygjeron edhe printim të raporteve, duke qenë se jo rrallë të dhënat e hedhura në sistem dalin të gabuara pas kërkimit.
- Bashkia Elbasan nuk ka fond të veçantë për dhunën, por me buxhetin e saj kryen pagesën mujore të koordinatorës.
- Me Zyrën Rajonale të Punësimit Elbasan bashkia ka bashkëpunim të ndërsjelltë dhe konkretisht janë arritur të punësohen 7 raste të grave me probleme dhune të pajisura me UMM/UM.
- Për vitin 2018 nuk është plotësuar asnjë kërkesë për UMM/UM nga Bashkia Elbasan.
- Gjatë vitit 2018 vetëm Forumi i Gruas Elbasan ka plotësuar dy kërkesa për UMM/UM dhe një ankesë për rrëzim urdhëri.
- Përgjatë vitit 2018, nuk ka asnjë rast të referur nga Bashkia në Strehëzën Kombëtare për Viktimat e Dhunës në Familje i ardhur nga Bashkia Elbasan.
- Shoqata Tjetër Vizion e cila në mënyrë direkte merret me trajtimin e dhunuesve, për vitin 2018 ka trajtuar 11 raste të burrave dhunues.

Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Elbasan

Bashkia Elbasan në mbështetje të kuadrit ligjor ndërkombëtar e kombëtar, si dhe të prioriteteve kombëtare dhe vendore, ka bërë përpjekjet e saj për ndërtimin e një shoqërie të mundësive të barabarta, duke ndërmarrë një sërë hapash konkretë në këtë drejtim.

Këshilli Bashkiak i Elbasanit miratoi në mbledhjen e datës 25.05.2018, “*Planin e Veprimit për Barazi Gjinore 2018-2020*”, procesi i hartimi i të cilit u mbështet me asistencë teknike nga UN Women për Shqipërinë. Ky plan mbulon një tërësi fushash dhe në të parashikohen e propozohen të tjera masa dhe veprime që synojnë adresimin e mëtejshëm të çështjeve të pabarazive dhe diskriminimit, respektimin e të drejtave të barazisë burrë - grua; trajtimin e çështjeve të pabarazisë dhe diskriminimit; veprime për eliminimin e stereotipeve gjinore etj. Veprimet dhe masat e parashikuara në këtë plan mbështeten në Kartën Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore si dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore. Para hartimit të këtij plani bashkia organizoi dy takime konsultuese me OJF-të dhe me drejtorët e drejtorive në bashki, në muajt Shkurt dhe Mars 2018.

Në kuadër të këtij plani u ngritën këto organizma:

- Aleanca e Grave Këshilltare në Këshillin Bashkiak të Bashkisë Elbasan;
- Komisioni i Barazisë Gjinore, i bashkëngjitur komisioneve të tjera të Këshillit Bashkiak, i cili do të shqyrtojë të gjitha vendimet e Këshillit me këndvështrim gjinor.

Sipas të dhënave nga kjo bashki, Këshilli Bashkiak i Elbasanit, në mbledhjen e tij të datës 22.06.2018 u informua mbi situatën e barazisë gjinore (BGJ) dhe dhunës në familje (DHF). Bashkia e Elbasanit, në mbështetje të kuadrit ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar, si dhe të prioriteteve kombëtare dhe vendore ka bërë përpjekjet e saj ndër vite për ndërtimin e një shoqërie të mundësive të barabarta, duke ndërmarrë një sërë hapash në këtë drejtim.

Bashkia e Elbasanit është e para bashki në Shqipëri që ka aplikuar fillimisht parimet e Buxhetimit me Pjesëmarrje e më pas të Buxhetimit Gjinor. Buxhetimi me Pjesëmarrje është një nismë e prezantuar nga bashkia me qëllim forcimin e qasjes pjesëmarrëse së qeverisjes vendore në Elbasan. Buxhetimi është një metodë përmes së cilës gratë dhe burrat ndikojnë vendimmarrjen lokale dhe shpërndarjen e burimeve publike për të pasqyruar më mirë nevojat dhe përparësitë e komunitetit. Me mbështetjen UN Woman, kjo bashki ka krijuar një model të qëndrueshëm e të ndjeshëm gjinor të buxhetimit pjesëmarrës.

Në vijim, në datë 04.12.2018, në Bashkinë e Elbasanit u organizua takimi lançues i Aleancës së Grave të Qarkut të Elbasanit në të cilin morën pjesë Kryetari i bashkisë Z.Qazim Sejdini, Zv.Kryeministrja Senida Mesi, përfaqësues të UN Women në Shqipëri dhe përfaqësues nga Rrjeti Kombëtar i Aleancave të Grave Këshilltare.

Drejtoria Vendore e Policisë Qarkut Elbasan ka në vartësi të saj 5 komisariate, përkatësisht Bashkia Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cerrik, Peqin si dhe dy Posta policie në Bashkinë Belsh

dhe Prrenjas. Puna e policisë në mbështetje të grave të dhunuara është shumë pozitive në këtë qark.

Nga të dhënat e Bashkisë Elbasan, konfirmohet se Specialistët e Policisë së Zonës janë ata që i presin viktimat, i marrin deklaratat, i orientojnë se ku duhet të shkojnë për të marrë ndihmë të mëtejshme, duke i referuar e shoqëruar tek koordinatori e dhunës në Bashkinë Elbasan dhe në organizatën “*Forumi i Gruas Elbasan*” (FGE).

Edhe për 2018, FGE ka organizuar sesione informimi me SPZ-të për DHF të cilat janë fokusuar në informimin e SPZ-ve (*Specialist i Policisë së Zonës*) në lidhje me ndryshimet e bëra në ligjin e dhunës, mbi DHF, plotësimin e UMM/UM, mikpritjen e viktimave të dhunës/fëmijëve dhe referimin sipas rastit. FGE mban lidhje të vazhdueshme me SPZ-të në mënyrë që të shmangen konfliktet e incidentet e mëvonshme të dhunës e për të siguruar jetën e viktimave dhe fëmijëve të tyre.

Nga të dhënat statistikore nga Drejtoria e Përgjithshme Tiranë, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë, Bashkia Elbasan, janë evidentuar 192 raste të dhunës në familje dhe janë paraqitur 120 kërkesa për Urdhër Mbrojtje. Ndërkohë që 145 ishin gratë dhe vajzat të cilat ishin viktimat të dhunës në familje ku 67 prej tyre ishin dëmtuar nga bashkëshorti apo partneri.

Tabela 1. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Bashkisë Elbasan

Dhuna në familje	DVP Elbasan	Burra	Gra
Raste te evidentuara	192		
Vrasje raste			
Viktima			145
Kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje	120		
Shkelje Urdhër Mbrojtje	2		
Vepër penale- Neni 130/a	57		
Autorë të arrestuar	27		
Autorë të ndaluar	1		
Autorë të shpallur në kërkim			
Autorë në gjendje të lire			
Autorë të vetvuarë			

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Tiranë

Ndërkohë, Mekanizmi i Referimit kundër dhunës në Familje në bashkinë Elbasan mbledhet në mënyrë periodike për adresimin e çështjeve të barazisë gjinore dhe dhunës në familje dhe përgjatë vitit 2018 ky mekanizëm ka trajtuar 103 raste të dhunës në familje.

Bazuar në Ligjin Nr.9669 datë 18.12.2006 për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare për vitin kalendarik 2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar 224 urdhëra të rinj, nga të cilët 150 UM dhe 69 UMM.

Politika që ka ndjekur Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për vitin 2018, ka patur në fokus kryesor viktimat vulnerabël, ato që pësojnë çënime në të drejtat dhe liritë e tyre për shkak të gjinisë së tyre si dhe të miturit. Sipas të dhënave nga kjo prokurori përgjatë vitit 2018 janë regjistruar rastet vijuese:

Neni 130/a i Kodit Penal:

- Mosfilluar 6 çështje;
- Mbartur 29 çështje, me 22 të pandehur, me 5 të arrestuar;
- Rregjistruar 87 çështje, me 23 persona nën hetim, 52 të pandehur, 31 të arrestuar;
- Pushuar 11 çështje, me 8 persona nën hetim, 1 i arrestuar;
- Pezulluar 1 çështje;
- Transferuar 2 çështje, me 2 persona nën hetim;
- Dërguar gjyqit 71 çështje, me 74 të pandehur, 30 të arrestuar;
- Mbetur në hetim 31 çështje, me 13 persona nën hetim, 5 të arrestuar;
- Gjykuar 63 çështje, me 68 të pandehur (6 çështje me gjykim të zakonshëm dhe 57 çështje me gjykim të shkurtuar)
- Prokurori ka kërkuar dënimin me burgim në minimum për 37 të pandehur, dënim me burgim mesatar për 5 të pandehur, dënim me burgim dhe aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal për 26 të pandehur;
- Gjykata ka vendosur dënimin me burgim me minimum për 36 të pandehur, dënimin mesatar për 4 të pandehur, dënimin me burgim dhe zbatimin e nenit 59 të Kodit Penal për 26 të pandehur, në 1 rast ka vendosur kthimin e akteve dhe në 1 rast pushimin e çështjes.

Përsa i përket masave të sigurimit, rezulton se:

- Janë kryer arrestime në flagrancë në 43 raste, për të cilat prokurori ka kërkuar vleftësimin si të ligjshëm;
- Për 36 raste prokurori ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit „arrest në burg“ parashikuar nga gjykata dhe kjo e fundit e ka dhënë në 34 raste;
- Për 6 raste prokurori ka kërkuar „Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore“ parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale dhe gjykata e ka dhënë në 8 raste;
- Për 1 rast prokurori ka kërkuar masë ndaluuese dhe gjykata e ka dhënë në 1 rast.

Procedime penale mbetur në hetim:

- Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, neni 124 – 130/a të Kodit Penal, janë gjithsej 39 çështje, me 13 persona nën hetim, 5 të arrestuar. 31 nga këto çështje penale janë për dhunën në familje.

Në vijm, për 1 të pandehur, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal, prokurori ka kërkuar pushimin për shkak se i pandehuri ka rezultuar i papërgjeshëm duke kërkuar caktimin e masës mjekësore.

Rezultatet e Monitorimit – Viti 2018

Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Bashkia Elbasan në bashkëpunim me institucione publike pjesë e mekanizmit referues ka organizuar fushata ndërgjegjësimi të komunitetit rreth dhunës me bazë gjinore dhe përpjekjet që duhen bërë për ta parandaluar këtë fenomen.

Bashkëpunimi ndërsektorial i bashkisë Elbasan me aktorët lokalë është fokusuar edhe në drejtim të sensibilizimit të komunitetit mbi çështje që kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave të grave/vajzave, fëmijëve, komunitetit rom etj.

Për vitin 2018 bashkia Elbasan në bashkëpunim me OJF-të si: FGE, Tjetër Vizion, World Vizion, A2B, Romano Sezzi si dhe institucione publike pjesë e mekanizmit referues ka realizuar disa fushata ndërgjegjësuese si:

1. Fushata lokale për Adresimin e Çështjeve të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore;
2. Fushata 16 Ditët e Aktivizmit për Barazinë Gjinore dhe kundër dhunës në familje;
3. Fushata ndërgjegjësuese në lidhje me të drejtat dhe fuqizimin e grave e vajzave.
4. Fushatë ndërgjegjësuese mbi të drejtat e fëmijëve Tetor - Nëntor 2018 e cila kulmoi me aktivitetin në kuadër të 20 Nëntorit Ditës Ndërkombetare të të Drejtave të Fëmijëve.

Gjatë vitit 2018, Bashkia Elbasan ka organizuar dhe koordinuar 42 aktivitete, në bashkëpunim me aktorët lokale publikë dhe ata jo publikë.

Në lidhje me mbulimin financiar, Bashkia nuk ka shpenzuar buxhet për aktivitetet ndërgjegjësuese, duke qenë se ka vënë në dispozicion burimet e veta njerëzore dhe në natyrë.

Rreth 5500 persona janë përfshirë në këto aktivitete përgjatë 2018-ës. Këto aktivitete më së shumti u fokusuan tek gratë/vajzat, burra/djem, të rinj/të reja, nxënës shkolle dhe studentë, target grupe gjithëpërfshirëse.

Çdo vit organizohen rreth 150 aktivitete ndërgjegjësuese që realizohen dhe koordinohen nga OSHC-të në territorin e bashkisë Elbasan. Këto aktivitete zakonisht janë: Forume në komunitet me burra/gra, vajza/djem, në zonat rurale dhe urbane, takime me nxënës të shkollave të mesme e 9/vjeçare, takime e leksione të hapura me studentë, sesione informuese me SPZ-te, mjekët e familjes, administratorët sociale, prindër e fëmijë, grupmosha e tretë, sesione fuqizuese me gratë e mbijetuara nga dhuna në familje etj.

OSHC-të bashkëkoordinuese në territorin e bashkisë Elbasan për vitin 2018 janë:

1. “Forumi i Gruas Elbasan”
2. “Tjetër Vizion”,
3. “World Vizion”
4. “A2B”
5. “Romano Sezzi”etj.

Bashkia Elbasan ka të nënshkruar disa marreveshje bashkepunimi me disa OJF, si me “*Forumi i Gruas Elbasan*”, “*Tjetër Vizion*”, “*World Vizion*”, “*A2B*”, “*Romano Sezzi*” Forumin e OSHC-ve. Ka gjithashtu marrëveshje edhe me organizata të tjera lokale, kombëtare që realizojnë projekte në territorin e bashkisë Elbasan.

Kjo bashki në bashkëpunim me OSCE, organizoi në datat 4-5 dhjetor 2018 trajnim të anëtareve të Komitetit Drejtues dhe Tryezes Teknike, lidhur me mekanizmin referues për bashkërendimin e punës në lidhje me viktimat e dhunës në familje.

Gjithashtu, në kuadër të rritjes së kapaciteteve të punonjësve në njësive administrative të bashkisë Elbasan, për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare u organizua me datë 25.10.2018, trajnimi me temë “*Mirëfunksionimi i Mekanizmit të referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ky i fundit.*” Ky trajnim u organizua nga shoqata Forumi i Gruas Elbasan në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan, me mbështetjen e UN Women Shqiperi, me qëllim rritjen e njohurive të aktorëve lokalë, sidomos të përfaqësuesve të institucioneve që merren drejtpërdrejtë me rastet e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në lidhje me funksionimin e Mekanizmit të Referimit të Dhunës në marrëdhëniet familjare dhe detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ky i fundit.

Bashkia Elbasan ka bashkëpunim të frytshëm dhe shumë pozitiv me organizata ndërkombëtare, si: PNUD, UN Women, USAID, OSCE etj.

Për 2018 bashkia Elbasan është bashkëfinancuese në shumën 25.000 \$ me PNUD në kuadër të Programi Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) që financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, për financim të përbashkët të OJF-ve brenda dhe jashtë Elbasanit. FGE është përfituese e këtij bashkëfinancimi me projektin “*Fuqizimi dhe ri-integrimi i grave/vajzave të mbijetuara të DHBGJ/DHF në Bashkinë Elbasan,*” Programi ReLOaD /UNDP për periudhën shtator 2017-shtator 2018.

Gjithashtu, procesi i hartimit të “*Planin e Veprimit për Barazi Gjinore 2018-2020*”, u mbështet me asistencë teknike nga UN Women Shqipëri.

Ndërkohë që me mbështetjen UN Woman, Bashkia e Elbasanit ka krijuar një model të qëndrueshëm e të ndjeshëm gjinor të buxhetimit me pjesëmarrje/gjinor.

Tabela 2. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Nr	Data	Vendi	Tema	Organizua nga:
1	13.11.2018	Spektori MFBGJ Bashkia Elbasan	Tryezë teknike me aktorët lokalë për Planifikimin e Aktiviteteve të Fushatës së 16-të ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore.	Bashkia Elbasan Aktorët lokalë
2	13.11.2018	Shkolla, “Luigj Gurakuqi”	Takim ndërgjegjësues në shkollën e mesme “Luigj Gurakuqi” për të diskutuar me vajza dhe djem mbi normat shoqërore dhe sjelljet që promovojnë barazinë gjinore.	Koordinatorja Vendore/Bashkia Elbasan Forumi i Gruas Elbasan
3	14.11.2018	Shkolla 9 vjeçare “Xhaferr Hakani”	Takim ndërgjegjësues “Bullizmi dhe Pasojat e tij në Shëndetin Mendor”	DSHP Infermier i shkollës DAR
4	15.11.2018	Shkolla 9 vjeçare “Naim Frashëri”	Takim ndërgjegjësues “Bullizmi dhe Pasojat e tij në Shëndetin Mendor”	DSHP Infermier i shkollës DAR
5	16.11.2018	NJ.A Bradashesh	Forum në komunitet për të diskutuar me gra, vajza, burra dhe djem mbi normat shoqërore dhe sjelljet që promovojnë barazinë gjinore.	Koordinatorja Vendore Forumi i Gruas Elbasan P.social I NJ.A Bradashesh Zyra e Policimit në Komunitet
6	20.11.2018	Shkolla 9 vjeçare “Qamil Guranjaku”	Takim ndërgjegjësues “Bullizmi dhe Pasojat e tij në Shëndetin Mendor”	DSHP Infermier i shkollës DAR
7	21.11.2018	Shkolla 9 vjeçare “Fadil Gurmani”	Takim ndërgjegjësues “Bullizmi dhe Pasojat e tij në Shëndetin Mendor”	DSHP Infermier i shkollës DAR
8	22.11.2018	Qendra Komunitare Rome	Takim ndërgjegjësues “Bullizmi dhe Pasojat e tij në Shëndetin Mendor”	DSHP Infermier i shkollës

			Mendor”	DAR
9	23.11.2018	Bashkia Elbasan	Mbledhje e Komitetit Drejtues të Mekanizmit të Referimit të rasteve të dhunës në familje.	Bashkia Elbasan Aktorë lokalë
10	23.11.2018	Shkolla 9 vjeçare “Luigj Gurakuqi”	Takim ndërgjegjësues “Bullizmi dhe Pasojat e tij në Shëndetin Mendor”	DSHP Infermier i shkollës DAR
11	26.11.2018	Shkolla 9 vjeçare “Ali Agjahu”	Takim ndërgjegjësues “Bullizmi dhe Pasojat e tij në Shëndetin Mendor”	DSHP Infermier i shkollës DAR
12	26.11.2018	Nj.A Labinot Fushë	Hapja e fushatës me sloganin “Vepro tani-Barazia Gjinore fillon nga ti” shpërndarja e fjongove portokalli në institucione-Njësinë Administrative Labinot Fushë në shkolla dhe qytetarëve.	Shoqata “Në dobi të komunitetit dhe shtresave në nevojë“ DAR Punonjësi Socilal i NJ.A Labinot Fushë
13	26.11.2018	Shkolla e mesme "Luigj Gurakuqi"	Kënd informues për barazinë gjinore, me vajza/djem, nxënës të shkollës.	Fondacioni Ndhimë për Ballkanin Koordinatorja Vendore/Bashkia Elbasan Policia DAR
14	27.11.2018	Fondacioni Ndhimë për Ballkanin	Takim informues për shërbimet ekzistuese të përkujdesit shoqëror që i ofrohen rasteve të dhunës në familje në Bashkinë Elbasan	Fondacioni Ndhimë për Ballkanin Koordinatorja Vendore/Bashkia Elbasan
15	27.11.2018	Shkolla 9 vjeçare “Jorgji Dilo”	Takim ndërgjegjësues “Bullizmi dhe Pasojat e tij në Shëndetin Mendor”	DSHP Infermier i shkollës DAR
16	27.11.2018	Konsultor Marteniteti	Takim ndërgjegjësues me vajzat/gratë në kuadër të “Ditës Botërore të Lindjeve të	Zyra e Promocionit DSHP Elbasan

		Elbasan	Parakohshme”	
17	27.11.2018	NJ.A Labinot Fushë Shkolla e mesme Labinot Fushë	Projekti i bluzave me mesazhe kundër dhunës me nxënës mësues dhe prindër.	Shoqata “Në dobi të komunitetit dhe shtresave në nevojë“ DAR Punonjësi Social i NJ.A Labinot Fushë
18	28.11.2018	NJ.A Labinot Fushë Shkolla 9 vjeçare Labinot Fushë	Diskutojmë mbi filmin. Ekspozitë me vizatime, postera dhe ese të nxënësve.	Shoqata “Në dobi të komunitetit dhe shtresave në nevojë“ DAR Punonjësi Social i NJ.A Labinot Fushë
19	29.11.2018	NJ.A Labinot Fushë Shkolla e mesme Labinot Fushë	Takim me mësues dhe prindër në shkollën e mesme Labinot Fushë me temë “Dhuna me Bazë Gjinore”	Shoqata “Në dobi të komunitetit dhe shtresave në nevojë“ DAR Punonjësi Social i NJ.A Labinot Fushë
20	30/11/2018	Qendra komunitare Ndihmë për Ballkanin	Takim informues për shërbimet ekzistuese të përkujdesit shoqëror që i ofrohen rasteve të dhunës në familje në Bashkinë Elbasan/Përfituesit e qendrës në Rajonin Nr. 3	Koordinatorja Vendore Bashkia Elbasan Ndihmë për Ballkanin
21	30.11.2018	Nj.A. Nr.4	Forum në komunitet në Njësinë nr.4 në Bashkinë Elbasan për të diskutuar me gra, vajza, burra dhe djem mbi nornat shoqërore dhe sjelljet që promovojnë barazinë gjinore.	Koordinatorja Vendore Forumi i Gruas Elbasan Administratori Shoqëror Lagja Nr.4 P.social i lagjes Nr.4 Zyra e Policimit në Komunitet Nr.4

22	30.11.2018	Nj.A Labinot Fushë Shkolla 9-vjeçare Mengel	Takim me mësues dhe prindër në shkollën 9-vjeçare Mengel me temë “Dhuna me Bazë Gjinore”	Shoqata “Në dobi të komunitetit dhe shtresave në nevojë“ DAR Punonjësi Social i NJ.A Labinot Fushë
23	01.12.2018	Fondacioni Ndihmë për Ballkanin	Takim informues për shërbimet ekzistuese të përkujdesit shoqëror që i ofrohen rasteve të dhunës në familje në Bashkinë Elbasan. Familjet që mbështeten nga fondacioni.	Koordinatori Vendore Fondacioni Ndihmë për Ballkanin
24	02.12.2018	Nj.A Shirgjan	Takim ndërgjegjësues në komunitet, me temë "Dhuna ndaj Grave"	Koordinatori Vendore Fondacioni Ndihmë për Ballkanin
25	03.12.2018	Shoqata Tjetër Vizion	Takim informues për shërbimet ekzistuese të përkujdesit shoqëror që i ofrohen rasteve të dhunës në familje në Bashkinë Elbasan. Përfituesit e kurseve profesionale.	Zyra e Promocionit DSHP Elbasan Nj.A Shirgjan
26	03.12.2018	Shkolla mesme “Kostandin Kristoforidhi”	Kënd informues për barazinë gjinore, me vajza/djem, nxënës të shkollës.	Koordinatori Vendor NJMF Shoqata Tjetër Vizion
27	03.12.2018	Nj.A Labinot Fushë Shkolla 9-vjeçare Mengel	Një aktivitet sportiv me sloganin “Djemtë dhe vajzat sëbashku” me nxënësit e shkollës 9-vjeçare Mengel. Ekspozitë me punime të nxënësve.	Forumi i Gruas Elbasan DAR Koordinatori Vendor
28	04.12.2018	Universiteti “Aleksandër Xhuvani	Leksion i hapur me studentë të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” për të diskutuar mbi normat shoqërore dhe sjelljet që promovojë barazinë gjinore.	Shoqata “Në dobi të komunitetit dhe shtresave në nevojë“ DAR Punonjësi Social i NJ.A Labinot

				Fushë
29	04.12.2018	Shkolla mesme "Kostandin Kristoforidhi"	Kënd informues për barazinë gjinore, me vajza/djem, nxënës të shkollës.	Forumi i Gruas Elbasan Koordinatorja Vendore/Bashkia Elbasan
30	04.12.2018	Nj.A Labinot Fushë Shkolla 9-vjeçare Griqan	Takim me mësues dhe prindër në shkollën 9-vjeçare Griqan i Poshtëm me temë "Dhuna me Bazë Gjinore"	Forumi i Gruas Elbasan Koordinatorja Vendore/Bashkia Elbasan Polici
31	05.12.2018	Qendra Komunitare Rome	Takim informues për shërbimet ekzistuese të përkujdesit shoqëror që i ofrohen rasteve të dhunës në familje në Bashkinë Elbasan. Komuniteti Rom	Shoqata "Në dobi të komunitetit dhe shtresave në nevojë" DAR Punonjësi Social i NJ.A Labinot Fushë
32	05.12.2018	Nj.A Labinot Fushë Shkolla 9-vjeçare Griqan	Takim me mësues dhe prindër në shkollën 9-vjeçare Griqan i Poshtëm me temë "Dhuna me Bazë Gjinore"	Koordinatorja Vendore Qendra Komunitare Rome
33	06.12.2018	Shkolla mesme "Dhaskal Todhri"	Kënd informues për barazinë gjinore, me vajza/djem, nxënës të shkollës.	Shoqata "Në dobi të komunitetit dhe shtresave në nevojë" DAR Punonjësi Social i NJ.A Labinot Fushë
34	06.12.2018	Nj.A Labinot Fushë Shkolla 9-vjeçare Griqan	Konkursi "Njoh të drejtat e mia" (Konventën e të drejtave të fëmijëve dhe të drejtat e njeriut) midis nxënësve të shkollave 9- vjeçare Griqan. Ekspozitë me punime dhe dramatizime.	Forumi i Gruas Elbasan DAR Kordinatorja Vendore
35	07.12.2018	Shkolla e mesme "Ali Myftiu"	Kënde Informimi Lëvizëse. Seancë ndërgjegjësimit mbi	Shoqata "Në dobi të komunitetit dhe shtresave në

			DHF, shërbimet policore, shërbimet mbështetëse për viktimat dhe familjarët.	nevojë“ DAR Punonjësi Social i NJ.A Labinot Fushë
36	07.12.2018	Nj.A Labinot Fushë	Takim me punonjës në Njësinë Administrative Labinot Fushë për të diskutuar si mund të nxisim kulturën e barazisë dhe respektit në mesin e të rinjve, si mund të sfidojmë incidentet e DHBZ dhe si mund të mbështesim viktimat e të dhunës.	Fondacioni “Ndihmë për Ballkanin – A2B”, Koordinatorja Vendore Bashkia Elbasan, Seksioni MM & DHF Drejtoria Vendore Policisë Elbasan SPZ Elbasan Psikologu i shkollës Kryetari i NJA nr3 Elbasan.
37	10 dhjetor	Shkolla e mesme "Sali Ceka"	Kënde Informimi Lëvizëse. Seancë ndërgjegjësimi mbi DHF, shërbimet policore, shërbimet mbështetëse për viktimat dhe familjarët.	Shoqata “Në dobi të komunitetit dhe shtresave në nevojë“ Nj.A Labinot Fushë.
38	10.12.2018	Nj.A Labinot Fushë Shkolla e mesme Labinot Fushë	Aktivitet argëtues dhe sensibilizues përmbyllës në shkollën e mesme Labinot Fushë ku nxënësit do të japin mesazhet e tyre për bashkëmoshatarët, prindrit dhe mësuesit nëpërmjet ekspozitave me vizatime dhe postera, ese, dramatizime etj.	Fondacioni “Ndihmë për Ballkanin – A2B”, Koordinatorja Vendore Bashkia Elbasan, Seksioni MM & DHF Drejtoria Vendore Policisë Elbasan SPZ Elbasan Psikologu i shkollës Kryetari i NJA nr3 Elbasan.

39	17- 20.12.2018		Aktivite festive me femijë me rastin e festave të fund vitit.	Shoqata “Në dobi të komunitetit dhe shtresave në nevojë“ DAR Punonjësi Social i NJ.A Labinot Fushë
----	-------------------	--	---	---

Burimi: Bashkia Elbasan

Duke qenë se Objektivi 3.1 i strategjisë kërkon gjithashtu koordinim dhe bashkëpunim ndërmjet pushtetit vendor dhe organizatave me bazë fetare për trajnim dhe organizim të aktiviteteve të përbashkëta, Këshilli i Qarkut Elbasan, bashkia Elbasan dhe Drejtoria e Spitalit Rajonal Elbasan në bashkëpunim me Qendrën e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë, organizuan Konferencën Rajonale “E drejta e fëmijës, për kujdes dhe shërbime shëndetësore”.

Tabela 3. Tabela e aktiviteteve në bashkëpunim me organizata fetare

Nr	Data	Vendi	Tema	Organizua nga:
1	19.12.2018	Hotel “Skampa” Elbasan	“E drejta e fëmijës, për kujdes dhe shërbime shëndetësore ”	Bashkia Elbasan ; Këshilli i Qarkut Elbasan; Qendra e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë

Burimi: Bashkia Elbasan

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Bashkia Elbasan luan një rol shumë të rëndësishëm në Mekanizimin e Referimit pranë kësaj bashkie. Kur një viktimë e dhunës në familje (*dhe kushdo që mund të raportojë dhunën në familje*) i drejtohet Bashkisë Elbasan, atëherë në bashkëpunim me Policinë nis procesi i vlerësimit të rastit të refruar i cili përfshin:

- një intervistë me viktimën,
- me abuzuesin, si dhe me anëtarë të tjerë të familjes,
- vlerësim të nivelit të dhunës,
- dokumentim të kujdesshëm të fakteve,
- shoqërimin në institucionet e shëndetit parësor (nëse është e nevojshme),
- si dhe transportimin e viktimës së dhunës në një vend të sigurt.

Koordinatorja dhe punonjësi i policisë si përfaqësuesit e ekipit ndërinstitucional përcaktojnë se cilët anëtarë të tjerë dhe cilat burime nevojiten për ndërhyrjen e parë dhe/ose të menjëhershme në vijim. Pas dhënies së ndihmës së parë viktimës së dhunës, koordinatorja e dhunës shtron rastin për shqyrtim në mbledhjen e ekipit teknik ndërdisiplinor.

Duhet theksuar se për rastet që nuk kërkojnë ndërhyrje emergjente kërkohet respektimi i vullnetit të viktimës së rritur lidhur me referimin e rastit. Këto janë rastet kur dhuna në familje ka mundësi që të trajtohet edhe pa një UM/UMM. Në punën e përditshme nuk mungojnë raste që mund/duhet të vlerësohen si të tilla kur bëhet fjalë për episode krejt rastësore dhe të shkëputura ku 'agresiviteti' i dhunuesit dhe lëndimi i viktimës mund të jenë pjesë e trajtimit psiko-social. Pa dyshim që për këtë kërkohet shumë seriozitet dhe kujdes me qëllim mbrojtjen e veçantë të familjes dhe të anëtarëve të saj. Në mbledhjet e mbajtura për shqyrtimin e rastit, anëtarët e ekipit teknik ndërdisiplinor hartojnë një plan të përbashkët ndërhyrjeje për zgjidhjen afatgjatë të rastit të trajtuar.

Menaxhimi i rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare në Bashkinë Elbasan kalon nëpër keto etapa:

1. Identifikimi
2. Referimi
3. Vlerësimi i plotë i rastit
4. Mbledhja e ekipit teknik ndërdisiplinor
5. Hartimi i planit individual
6. Monitorimi
7. Mbyllja e rastit

Mbështetja ndërsektoriale për rastet e dhunës në familje është ofruar nga funksionimi i Grupit Teknik Ndërdisiplinor për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Ky ekip mblidhet çdo 2 muaj dhe gjithashtu sa herë është e nevojshme për rastet emergjente. Për vitin 2018 janë realizuar 7 takime në të cilat janë trajtuar rastet e identifikuara apo të referuara.

Mekanizmi i Referimit kundër dhunës në Familje në bashkinë Elbasan përgjatë vitit ka trajtuar 103 raste të dhunës në familje.

Në vijim 61 raste ishin UM/UMM, 32 raste u mbështetën pa UM dhe 5 raste u rrëzuan si kërkesë padi nga Gjykata e rrethit.

Referuar rasteve të mësipërme (103), 76 prej tyre ishin raste dhune e ushtruar ndaj bashkëshortes ose ish/bashkëshortes; 13 raste u raportuan dhunë ndaj fëmijës; 4 raste dhune e ushtruar ndërmjet vëllezërve dhe 5 raste të dhunës së ushtruar ndaj moshës së tretë.

Pas raportimit dhe shqyrtimit të rasteve të dhunës nga Mekanizmi i Referimit kundër dhunës në familje u ofruan shërbimet vijuese:

- 103 raste - mbështetje psiko sociale dhe emocionale;

- 25 raste - konsulentë dhe mbështetje ligjore;
- 15 raste - strehim emergjent;
- 5 raste - transport në një vend të sigurtë;
- 18 raste - mbështetje ekonomike si rastet në nevojë;
- 76 raste - mbështetje ekonomike për shkak të UM;
- 23 raste - paketa ushqimore;
- 3 raste - sipas specifikave të rastit, gjetjen e banesës me qera;
- 4 kryefamiljarë - përfitimi bonus qeraje;
- 42 raste - kujdes shëndetsore, mundësimi i ilaçeve për nënat dhe fëmijët e tyre;
- 48 raste - referimi për ndjekjen e një kursi profesional;
- 7 raste - punësimi i rastit duke koordinuar me Zyren Rajonale të Punësimit Elbasan;
- 8 raste - për rregjistrimin e fëmijëve përkatësisht në shkollë dhe cerdhe;
- 3 raste - pagesa e çerdhes;
- 12 raste - pagesa e kopshtit.

Fondi social i vënë në dispozicion të shërbimeve nga bashkia është 20 milion lekë të vjetra. Shpenzimet për rastet e grave të pajisura me UMM/UM janë 90.000 lekë të reja që përdoren për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën e zgjatjes së UMM/UM. Ndërsa fondi për marrjen e ndihmës ekonomike pas përfundimit të UMM/UM me fondet e bashkisë është 3 milion lekë të reja. Gjithashtu, fondi për mbulimin e transportit të fëmijëve me aftësi ndryshe PAK, tek shkolla “Zëra Jete”, Qendra e fëmijëve Autik, etj.

8 është numri i grave të dhunuara që kanë marrë bonuse, gra të cilat i përkasin komunitetit Rom dhe Egjiptian të cilat janë trajtuar gjatë vitit 2018 me bonus social.

Megjithë angazhimin dhe punën e vazhdueshme, Mekanizmi i Referimit përballet me sfida dhe vështirësi në rastet e dhunës në familje si psh:

- Mbledhja e statistikave në nivel vendor për rastet e referuara dhe të menaxhuara në Bashkinë Elbasan;
- Nevoja për qendër rehabilitimi për rastet e dhunës në familje me qëndrim afatgjatë;
- Fondi specifik për mbështetjen me shërbime emergjente të rasteve të dhunës në familje;

Ndërkohë që kërkohet edhe rritja e kapaciteteve të Ekipit teknik ndërdisiplinor në:

- Identifikimin e hershëm;
- Te kuptuarit e njëjtë të rriskut dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje;
- Punësimin dhe Strehimin afatgjatë.

Shërbimi i Provës bashkëpunon me institucione dhe OJF të ndryshme në bazë të memorandumeve të bashkëpunimit për referimin e rasteve sipas specifikës së tyre. Përgjatë periudhës Janar – Dhjetor 2018 ky institucion ka trajtuar 17 Urdhëra ekzekutimi për UM, për ata burra që gjykata ka vendosur paraqitje në zyrën e shërbimit të provës.

Si praktikë pune e këtij institucioni është kontaktimi i personit brenda 5 ditëve nga vendimi. Në vijim kryhet një intervistë ku merren të dhëna për situatën social ekonomike, si dhe rrethanat të cilat e kanë shtyrë personin që të ushtrojë dhunë në familje. Mbi këto bazë hartohet një program individual i trajtimit të çdo dhunuesi, ku përcaktohen metodat e ndërhyrjes për të bërë të mundur ndryshimin e mendimit si dhe të mentalitetit për të mos përdorur dhunë në familje.

Paralelisht, vendosen kontakte me familjarët e dhunuesit si dhe kontaktohet edhe gruaja e dhunuar. Në vijim, monitorohen marrëdhëniet familjare me fëmijët, kontakti me gruan e dhunuar, duke i kushtuar rendësi shkaqeve të dhunës, mënyrën e ndryshimit dhe të pendimit që shfaqin dhunuesit.

Nga 17 raste të trajtura, 16 prej tyre konsiderohen të suksesshme. Këta persona raportohet se kanë hequr dorë nga dhuna dhe kanë përmirësuar marrëdhëniet familjare me gratë dhe fëmijët.

Në lidhje me takimet e GTN-së, pjesëmarrës të rregullt në takime janë Bashkia Elbasan, Shërbimet Shëndetësore, Policia, Drejtoria Arsimore dhe tre organizata të shoqërisë civile. Nga ana tjetër Prokuroria, Gjykata, Shërbimi Përmbarrimor, Zyra e Punës dhe Shërbimi i Provës rrallë herë marrin pjesë në këto takime.

Bashkia Elbasan që nga viti 2010 ka të emëruar një Nëpunëse të Barazisë Gjimore që luan edhe rolin e Koordinatorës Vendore kundër dhunës në familje, e cila është znj. Marsida Sejдини. Ndërkohë që në Planin e Mbrojtjes Sociale 2016-2020 dhe në *“Planin e Veprimit për Barazinë Gjimore 2018-2020”* të kësaj Bashkie, ku është sugjeruar zgjerimi i *“Sektorit të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjimore”*, si dhe propozimi për ndarjen e funksioneve të Nëpunëses së Barazisë Gjimore dhe Koordinatorës Vendore kundër dhunës në familje, përmes emërimit të dy personave me kohë të plotë. Koordinatori vendor ka statusin e nepunësit civil dhe në këto raste nuk ka kontratë. Ndërkohë që për vitin 2018 nuk ka marrë asnjë trajnim specifik.

Sistemi online përditësohet nga koordinatoresha sa herë ka raportime që duhen hedhur në sistem, megjithatë ky i fundit ka nevojë për ndryshime në mënyrë që të funksionojë me më tepër efikasitet. Sipas kontaktit me koordinatoren dhe informacionit të marrë, ky sistem ka nevojë për ndryshim moduli sipas specifikave të veçanta që ka çdo rast. Gjithashtu, sygjeron edhe printim të raportve, duke qenë se jo rrallë të dhënat e hedhura në sistem dalin të gabuara pas kërkimit. *P.sh. Nëse kërkon që të hysh në bashkinë Elbasan, ka raste që del informacioni i tjetër bashkie, në këtë rast në vend të të dhënave të Elbasanit dalin ato të Beratit.*

Bashkia Elbasan nuk ka një fond të veçantë për dhunën, por kryen pagesën mujore të koordinatoresha vendore kundër dhunës në familje.

Megjithëse nuk ka një marrëveshje formale me policinë, koordinatoresha e dhunës dërgon çdo muaj të dhënat përkatëse dhe raportin ecurinë e punës në GTN për çdo mbledhje. Dokumenta që faktojnë këtë bashkëpunim janë verbale të tryezave teknike, ku përfaqësuesit nga policia

janë gjithmonë të pranishëm, referimet e rasteve nga policia për ndihmë e mbështetje të Bashkisë etj.

Ndërkohë që me Zyrën Rajonale të Punësimit Elbasan, ka bashkëpunim të ndërsjelltë dhe konkretisht janë arritur të punësohen 7 raste të grave me probleme dhune të pajisura me UMM/UM.

Me Drejtorinë Arsimore Rajonale ka bashkëpunim në organizimin e fushatave të përbashkëta ndërgjegjësuese, në mbështetje për regjistrimin apo lëvizjen nga shkolla të fëmijëve të grave të dhunuara e të divorcuara, kur ndërrojnë banesë si dhe në pjesëmarrjen rregullisht në tryezën teknike të përfaqësuesve të DAR. Dokumentat që e faktojnë këtë bashkëpunim janë verbale të tryezave teknike, ku përfaqësuesit nga DAR janë gjithmonë të pranishëm.

Me Shërbimin Social ka bashkëpunim në pjesëmarrjen rregullisht në tryezën teknike të përfaqësuesve të këtij institucioni si dhe në pjesëmarrjen e tyre të fushatave të përbashkëta ndërgjegjësuese.

Ndërkohë që Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, mbështetur edhe në një analizë 6 (gjashtë) mujore, të kryer në lidhje me veprat penale me objekt dhunën me bazë gjinore, Urdhëri nr. 31 datë 30.04.2018 „Për organizimin dhe funksionimin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan“, pësoi ndryshime, duke u krijuar Seksioni për hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të veprave penale kundër personit, krimeve kundër jetës, veprat penale me objekt dhunën me bazë gjinore etj. Këtij seksioni në hetimin e veprave penale me objekt dhunën me bazë gjinore, iu atashuan edhe 2 oficerët e policisë gjyqësore të Seksionit për hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të veprave penale me autorë apo të dëmtuar të mitur, duke pasur parasysh specializimin e tyre. Në këtë kuadër, me Udhëzimin nr. 50 prot datë 02.07.2018 „Për mbajtjen e të dhënave statistikore në lidhje me çështjet penale që kanë si objekt dhunën me bazë gjinore“.

Drejtuuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, udhëzoi mbajtjen e të dhënave specifike statistikore që lidhen me këto vepra penale, sipas një table bashkangjitur udhëzimi. Mbajtja e këtyre të dhënave u vlerësua se do të ndihmojë, në analizimin e mëtejshëm të faktorëve që passjellin dhunën me bazë gjinore, me qëllim krijimin e politikave që do të mundësojë minimizimin e kësaj dhune.

Tabela 4. Numri i mbledhjeve të GTN-së në vitin 2018 në Bashkinë Elbasan

Data	Mbledhjet e GTN
26.1.2018	Në këtë takim u diskutua për rastet e reja dhe rastet që janë në menaxhim.
26.2.2018	Bashkia Elbasan në kuadër të aktiviteteve për adresimin e çështjeve që kanë në fokus të Drejtat e Vajzave/Grave në bashkëpunim me aktorët lokalë – Takimi i radhës i Tryezës Teknike për të planifikimin e aktiviteteve në kuadër të 8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas.

1.3.2018	Bashkërendimin e veprimtarive për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në nivel vendor
6.4.2018	U diskutuan rastet e menaxhuara të dhunës në familje gjatë periudhës janar-mars 2018. Prezantimi i gjetjeve të përgjithshme lidhur me situatën, shërbimet që ekzistojnë dhe modelet që propozohen të ngrihen për viktimat/të mbijetuarat e dhunës seksuale. Bërë nga UN Women, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit Shqiptar, Programin Ndërkombëtar të Trajnimit dhe Asistencës për Investigimin e Krimeve (ICITAP), UNDP dhe Ambasadën Hollandeze, si dhe me mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
2.6.2018	Takimi i Ekipit Teknik Nderdisiplinar lidhur me rastin e M.Lloshi, bazuar në ligjin nr.9669 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" dhe VKM 334 për "Bashkërendim të Punës për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare"
25.9.2018	Përgjegjësia që ka secili anëtar i ekipit ndërdisiplinor që të përcjellë tek koordinatori një herë në dy javë informacionin për të gjitha rastet e paraqitura apo të trajtuara nga institucioni i tij/saj, pavarësisht nëse ndërhyrja ka qenë e përbashkët, ndërdisiplinore, apo është trajtuar vetëm brenda për brenda institucionit të vet.
13.11.2018	Hartimi i planit të aktiviteteve të përbashkëta ndërgjegjësuese për fushatën e 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore me aktorë lokalë.

Burimi: Bashkia Elbasan

Tabela 5. Numri i mbledhjeve të KD-së për vitin 2018 në Bashkinë Elbasan

Viti	Mbledhjet e KD
2018	<p>20/06/2018</p> <p>Rritja e qëndrueshmërisë dhe performancës së KVS të bashkisë Elbasan dhe replikimi i eksperiencës pozitive të kesaj bashkie në bashkitë Gramsh dhe Prrenjas</p> <p>Bashkia dhe roli i saj në bashkëpunim me institucionet e në drejtim të rendit dhe sigurisë publik.</p> <p>Sipas drejtorit të policisë z.Altin Qato, problematikë është edhe dhuna në familje. Gjatë vitit 2018 janë evidentuar 51 vepra penale. Ka një trend rritjeje, por kjo vjen si rezultat i rritjes së besimit të komunitetit tek policia.</p> <p>Përsa i përket drogave, bashkia Elbasan është një bashki me rrisht të ulët të kultivimit të drogave, por ka një rrisht në përdorimin e tyre.</p>

2018	<p>06.11.2018</p> <p>Miratimi Plani i Veprimit të Këshillit Vendor të Sigurisë , Bashkia Elbasan (2018 - 2020)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shihet një trend në rritje të rasteve të dhunës pasi janë shtuar denoncimet nga të dhunuarit. • Situatat e dhunës dhe cenimi I sigurisë se jetes se grave të dhunuara edhe kur janë të paisura me UMM/UM • Gjatë 2018– janë evidentuar 36 vepra penale të dhunës në familje në bazë të nenit 130/a dhe 75 raste në bazë të ligjit 9669. • Ka një numër të ulët kallëzimesh nga personeli shëndetësor. • Probleme të shtuara kur palët ndajnë të njëjtin ambient qëndrimi (urdhërat e mbrojtjes) • Ka nevojë për kapacitete shtesë për qendrat e pritjes • Duhet vazhduar ndërgjegjësimi nëpër shkollat • Duhet vazhduar takimet në komunitet • Duhet që gjithë insitucionet e përfshira në VKM si pjesë e mekanizmit të kryejnë detyrat
2018	<p>23/11/2018</p> <p>Kjo mbledhje hapi fushatën e “16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore”, me synim ndërgjegjësimi i komunitetit rreth dhunës me bazë gjinore dhe përpjekjet që duhen bërë për ta parandaluar këtë fenomen”</p> <p>Mbështetja ndërsektoriale në trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare</p> <p>Rritja e rasteve të suksesshme nxjerr në pah mirëfunksionimin e Mekanizmit të Referimit të rasteve të dhunës në familje me të treja hallkat e tij.</p> <p>Raportim I gjetjeve të monitorimit të SKBGJ në Bashkinë Elbasan, për vitin 2017.</p>

Burimi: Burimi Bashkia Elbasan

Tabela 6. Këshilli Drejtues Bashkia Elbasan viti 2018

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2017
Bashkia	Qazim Sejdini Kryetar , Shefki Lika, Marsida Sejdini
Drejtoria e Policisë	Altin Qato, Emiljan Pashaj Fatbardha Menalla
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Ledio Sulkuqi
Prokuroria e Rrethit	Bledi Mustafaraj
Drejtoria Arsimore Rajonale	Sonila Luzi
Drejtoria e Shëndetit Publik	Xhevair Budani, Edri Stafa
Zyra e Përmbarimit	Merita Tirana
Prefektura	Eva Bica
Drejtoria Rajonale e Shërbimi Social	Blerina Teta, Alketa Binjaku
Zyra e Punësimit	Marsida Hyseni
Anetare e Këshillit Bashkiak	Alketa Ipeku
Anetare I Këshillit Bashkiak	Blendi Himçi
Shoqata Tjeter Vizion	Arjan Cala , Diana Kasa

Shoqata Ëorld Vizion	Illirjan Gjoni
Ndihme per Ballkanin, A2B	Alketa Hasani , Elona Deliu
Forumi i Gruas Elbasan	Dhoksa Quku
Qendra e bashkepunimit Nderfetar (K.Mysliman)	Arben Ramkaj
Qendra e bashkepunimit Nderfetar (K. Katolik)	Sokol Lulgjuraju
Mitropoliti K.Orthodhoks	Andon Merdani
Komuniteti Bektashi	Haxhi Admir Selmani
Qendra “ Rome”	Enver Mustafaraj
Media	Besim Dybeli

Burimi: Burimi Bashkia Elbasan

Tabela 7. GTN-ja e Bashkisë Elbasan viti 2018

Institucioni	Emër mbiemer i përfaqësuesit në vitin 2018
Bashkia	Marsida Sejdini
Drejtoria e Policisë	Fatbardha Menalla
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Ledio Sulkuqi
Prokuroria e Rrethit	
Drejtoria Arsimore Rajonale	Sonila Luzi
Drejtoria e Shëndetit Publik	Helga Konguli
Zyra e Përmbarimit	Merita Tirana
Prefektura	Eva Bici
Drejtoria Rajonale e Shërbimi Social	Blerina Teta, Alketa Binjaku
Zyra e Punësimit	Marsida Hyseni
Organizata Jo qeveritare Tjeter Vizion,, A2B, Ë. Vizion	Luljeta Qose, Alketa Hasani, Enkeleda Mitre.
Strehezat për viktimat e dhunës	
Komunitete fetare	
Dhoma e Avokatisë së Rrethit	

Burimi: Burimi Bashkia Elbasan

Në Bashkinë Elbasan, Urdhërat e Mbrojtjes dhe Urdhërat e Menjëhershëm të Mbrojtjes zakonisht plotësohen nga policia.

Për vitin 2018 nuk është plotësuar asnjë kërkesë për UMM/UM nga Bashkia, për arsye se gratë tërhiqen nga kërkesa për UMM/UM kur paraqiten pranë kësaj bashkie, ndërsa kur plotësohet nga policia çështja vazhdon edhe pse gruaja mund të tërhiqet.

Gjatë vitit 2018 vetëm Forumi i Gruas Elbasan ka plotësuar dy kërkesa për UMM/UM dhe një ankesë për rrëzim urdhëri. Kjo për arsye se gruaja shkon në polici për herë të parë për të bërë deklaratat dhe ka provat në favor të gruas së dhunuar. Theksohet se për rastet që policia i referon në Forumin e Gruas për mbështetje të mëtejshme, avokatja e SA-së së FGE-së, bën plotësim të UMM/UM si dhe mbështetjen e përfaqësim në gjykatë.

Përgjatë vitit 2018, nuk ka asnjë rast të referur nga Bashkia në Strehëzën Kombëtare për Viktimat e Dhunës në Familje i ardhur nga Bashkia Elbasan.

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin etyre, përmes programeve të specializuara.

Për vitin kalendarik 2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar 224 urdhëra të rinj, nga të cilët 150 UM dhe 69 UMM.

Procedurat e urdhërave nga përmbarimi për dhunuesit kalojnë nga Zyra Përmbarimore Elbasan, të cilëve këta urdhëra i shkojnë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor për të gjitha vendimet e gjykatës për UMM/UM në mënyrë që të ndjekin procedurat e ankimimit. Për vitin 2018 nuk ka pasur asnjë rast që të ketë paraqitur ankesë dhe të jetë ndjekur nga zyra përmbarimore Elbasan.

Rehabilitimi i dhunuesve dhe personave të dënuar njësoj si në vitin 2017 zhvillohet nga Shoqata Tjetër Vizion e cila ofron shërbimin për këshillimin psiko-social të burrave dhe djemve të dhunshëm në funksion të ri-edukimit të dhunës në marrëdhëniet familjare. Edhe pse në çdo rast dhunuesit janë këshilluar nga nëpunësi gjinor të paraqiten pranë këtij shërbimi, për vitin 2018 janë trajtuar vetëm 11 raste të burrave dhunues.

Një prej mangësive më të mëdha që vihet re nga monitorimi i implementimit të strategjisë lidhet me shërbimin e provës. Sipas të dhënave të përfuara nuk ka një bashkëpunim apo marrëveshje me shërbimin e provës dhe të dhënat e publikuara nga shërbimi i provës nuk janë të disagreguara sipas llojit të krimit, diçka që do të lehtësonte identifikimin e rasteve të dhunës në familje që kanë marrë dënime alternative.

Rekomandime

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Elbasanit për vitin 2018, më poshtë renditen disa rekomandime për përmirësimin e punës së funksionimit të Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Elbasan dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ (2016-2020), kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

- Rekomandohen mbledhje më të shpeshta dhe të rregullta të GTN-së, duke qenë se krahasuar me një vit më parë, këto mbledhje kanë qenë më të rralla (*vetëm 7*).

- Të nxitet nga ana e shoqërisë civile dhe të merren masa për vendosjen e shërbimit të rehabilitimit në vendimet e gjykatës proces ky që duhet ndjekur nga përpjekje të të gjithë aktorëve të përfshirë për t'u materializuar. Për vitin 2018, vetëm 11 burra dhunues kanë marrë shërbime rehabilitimi, shërbime këto to ofruara nga organizata të shoqërisë civile.
- Rekomandohet që të bëhet e mundur mbledhja e statistikave në nivel vendor për rastet e referuara dhe të menaxhuara në bashkinë Elbasan, duke qenë se jo shpesh mekanizimi i referimit pranë kësaj bashkie has në pengesa.
- Është e nevojshme gjetja e mundësive për ngritjen e kapaciteteve për një qendër rehabilitimi për rastet e dhunës në familje me qëndrim afatgjatë.
- Ngritja e një fondi specifik për mbështetjen me shërbime emergjente të rasteve të dhunës në familje.
- Rekomandohesh rishikimi i platformës online REVALB, duke qenë se jo rrallë herë kjo platformë ka gjeneruar probleme dhe të dhëna të gabuara.
- Të rriten kapacitetet e punonjësve të të gjitha institucioneve anëtarë të GTN-së, të përfshirë në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përmes trajnimeve për të menaxhuar me efikasitet rastet që paraqiten. (*Identifikimin e hershëm; Te kuptuarit e njëjtë të rrishtit dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje*)
- Nxitja e të gjithë aktorëve pjesë e Mekanizmit që të jenë prezent në çdo mbledhje që organizohet nga GTN e bashkisë Elbasan.
- Bashkia Elbasan duhet të alokojë fonde për fletëpalosje apo materiale të tjera ndërgjegjësuese.
- Shtimi i burimeve financiare dhe njerëzore për të përballuar volumin e punës, duke qenë se përgjegjësitë dhe shërbimet për viktimat e dhunës me bazë gjinore janë shtuar.
- Të përsoset baza ligjore duke përcaktuar detyrime për çdo institucion i përfshirë në VKM nr.334, datë 17.2.2011, Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij, të zbatojë detyrimet që ka.
- Të lobohet për problemet e strehimit. Qeveria qendrore t'i japë fonde Bashkive, për bonuse apo banesa sociale për viktimat e mbijetuara nga dhuna.
- Të krijohen mundësitë për punësimin e viktimave të dhunës në familje.
- Të ngrihen programe rehabilitimi për dhunesit.
- Të shikohet me përparësi ngritja e strukturave për plotësimin e objektivit të tretë të strategjisë kombëtare.